

Ka thënë Pejgamberi [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: "All-llahu [subhanehu ve teala] është i butë dhe e don të butën në çdo gjë, ia jep njeriut të butë dhe që përmbahet atë që s'ia jep asnjë njeriu."

"Çdo veprim i shoqëruar me butësi zbukurohet dhe nëse jo shëmtohet."

"Nëse All-llahu [subhanehu ve teala] e don ndonjërin i dhuron atij butësi dhe ato shtëpi që s'praktikojnë butësinë i ndalohen mirësitë."

"Tre cilësi nëse ndodhen tek ndonjë njeri All-llahu [subhanehu ve teala] do ia mbulojë të këqijat dhe do e fusi në Xhennet:

a- Butësia ndaj të dobëtis dhe ndaj të pafuqishmit.

b- Kujdesi ndaj prindërve.

c- Pëzëmërsi ndaj atyre që administron."

Kur një njeri hyri në xhami dhe urinoi sahabet kur e panë u çuan ta rrahin kurse i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] i ndaloi duke thënë: "Ne jemi dërguar për të lehtësuar dhe jo për të vështirësuar."

"All-llahu [subhanehu ve teala] e ka ndaluar që ta djegi zjarri i Xhehennemit atë njeri që është i butë, i përzemërt dhe i lehtë (jo i rëndë)."

"Ditën e Gjykimit do të thërrasi një thirrës njerzit e mirë dhe ata nisen me shpejtësi për në Xhennet, melaiKET i takojnë dhe i pyesin:

- Kush jeni ju që po nxitoni kaq shumë për në Xhennet?

- Ne jemi njerëzit e mirë, dhe nëse na është bërë padrejtësi kemi duruar dhe jemi sjellur me butësi."

Ka treguar i Dërguari i All-llahut [sal-

lall-llahu alejhi ve selem] që një popull e ka rrahur të dërguarin e tyre (pejgamberin e tyre) derisa e lanë në gjak. Dhe ai duke fshirë gjakun prej fytyre ka thënë: **"O All-llah fale popullin tim se nuk dijnë se ç'farë po bëjnë!"**

"Nuk është i fortë ai që mposht tjetrin, por i fortë është ai që mposht zemërimin dhe e përmban veten."

Kur mushrikët po e lëndonin të Dërguarin e All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] disa i thanë:

- "A nuk po e lut All-llahun [subhanehu ve teala] që ta shkatërrojë këtë popull?"

Ai iu përgjigj- "Unë nuk jam dërguar për të mallkuar, por për të mëshiruar."

Dhe kur u shtua edhe më shumë presioni ndaj të Dërguarit të All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem], All-llahu [subhanehu ve teala] dërgoi Xhebrailin dhe me të edhe melekun e maleve. Pasi i dhanë selamin, meleku i maleve i tha:

- "Më urdhëro dhe unë do t'i palos malet përmbi kokat e tyre!"

I Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem] i tha- "Jo se ndoshta All-llahu do të nxjerrë pasardhës prej tyre që të adhurojnë All-llahun."

Një mbret del për gjueti në shkretëtirë. Pasi largohet prej grupit e kap një etje e madhe ndërsa ujë nuk kishte. Aty pranë ndodhej një fshat. Ky me shpejtësi drejtohet për tek ky fshat. Papritur del një fëmijë i vogël që e tremb kalin dhe mbreti për pak sa nuk ra vetë, por i ra kurora mbretrore. Ky nxehet dhe e rreh këtë fëmijë me kamzhik për vdekje. Pas pak del nëna e këtij fëmije që e kishte të vetëm dhe kjo grua ishte bes-

imtare e mirë. Shikon fëmijën e saj të vdekur dhe një mbret të egër. Dhe pasi nuk i bën dot gjë u lut dhe tha: "O Zot im, je aq i butë sa që ky i paditur mendoj se Ti nuk ekziston, dhe mori fëmijën e saj ndërsa mbreti duke u kthyer rrugës ndërroi jetë."

Një ushtar pyeti një prej princave musliman, Ibrahim Ibn Ed'hem, ndërkohë që nuk e dinte që ishte princ, dhe i tha:

"Ku është qyteti (ndërtesat)?"

Dhe ky i tregoi me gisht nga varrezat. Ushtari kujtoi se ky po tallej me të dhe filloi t'i gjuante, derisa e gjakosi. Kur e mori vesh se ai ishte princi shkoi t'i kërkonte të falur dhe Ibrahim iu përgjigj:

- **"Kur ti po më rrihje mua, unë po e lusja All-llahun [subhanehu ve teala] që të fuste ty në Xhennet."**

- Ushtari i tha- "E pse?"

- Ibrahim i tha- **"Kur ti po më rrihje mua unë u tegova i butë me ty duke shpresuar Xhennetin dhe durova, dhe prej kësaj unë përfitova shumë sevape, dhe se ti u bërë shkaku që ma dhe këtë sevap kaq të madh prandaj e luta All-llahun [subhanehu ve teala] që të fuste ty në Xhennet."**

Një burrë e ofendoj dhe shau shumë keq Amr Ibn Ubejd dhe ky i fundit duroi derisa mbaroi pastaj i tha: **"All-llahu të shpërbleftë për gabimet që më tregove dhe ti faltë gjynahet që permende."**

Një njeri i hodhi një grusht dhë një dijetari dhe nxënësit e tij çohen për ta rrahur por ai i ndaloi dhe i thotë: **"Kush e meriton dënimin e zjarrit për një grusht dhë, ai e mori dënimin."**

Ka thënë i Dërguari i All-llahut [sal-lall-

llahu alejhi ve selem]: "Mos u zemëro dhe për ty është Xhenneti."

Ka thënë i Dërguari i All-llahut [sal-lall-llahu alejhi ve selem]: "Dija mësohet duke e kërkuar atë dhe butësia duke e praktikuar."

Ka thënë All-llahu [subhanehu ve teala]:
"Dhe ecin nëpër tokë me thjeshtësi dhe kur i flasin injorantët thojnë paqe (selam)..."

(Furkan 63)

Umer Ibn Hatab ka thënë: **"Kërkojeni dijen që ta mësoni dhe t'ia mësoni të tjerëve, sepse dija të fal qetësi dhe butësi."**

Ka thënë Ali Ibn Ebi Talib: **"Nuk është mirësi që të shtosh pasurinë dhe të kesh shumë fëmijë, por mirësi është të shtosh dijen dhe butësinë."**

Ka thënë Hasan El Basri: **"Kërkojeni dijen dhe zbukurojeni atë me butësinë."**

Nëse dikush të shan përgjigju: Nëse je gënjeshtar All-llahu [subhanehu ve teala] ta faltë gjynahun dhe nëse ke të drejtë All-llahu [subhanehu ve teala] ma faltë gjynahun.

Një njeri po pyeste një dijetar:

- **"Kam një konflikt dhe nëse largohem kam frikë se do të më quajnë frikacak i nënshtruar, i poshtëruar dhe i pavlerë."**

- Ai iu përgjigj- **"I poshtëruar është vetëm i padrejti."**

Ka thënë Uehb Ibn Muneb-bih: **"Kush mëshiron mëshirohet, kush hesht është larg konfliktit, kush është i paditur mposhtet, kush nxiton gabon, kush ndez sherrin nuk shpëton, kush nuk e len hipokrizinë do shahet, kush nuk e urren**

Klubi studentor

sherrin merr gjynah dhe kush zbaton rregullat e All-llahut ruhet prej Tij."

I shkon lajmi Malik Ibn Dinar që dikush e shau dhe ky shkon dhe i thotë: **"Kam marrë vesh se më ke sharë, pra ti qenke më bujar se unë ndërkohë që po ta bëjë unë atë veprim do të dhuroj nga të mirat e mija."**

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

On-line versionin e këtij teksti mund ta gjeni në:
<http://www.albislam.com/>

Boton:
Shoqata Qytetare
Klubi Studentor
Rr. Stiv Naumov 7 / 18
Tel. ++389 (02) 223-654
1000, Shkup



Zbukurimi i karakterit me butësi